

MËSIMI I GJERMANISHTES PËR TË ARDHURIT E RINJ

NË QYTETIN DHE QARKUN E HEILBRONN



Albanisch



H | N Heilbronn



PARATHËNIE

Ko broshurë informon mbi mundësit për të mësuar gjermanisht në qytetin dhe qarkun e Heilbronn. Prandaj ajo ndihmon njerëzit, të cilat vijnë rishtazi nga vende të huaja ose që jetojnë tashmë për një kohë të gjatë në Gjermani dhe nuk kanë ende ose kanë njohuri të vogla të gjuhës Gjermane. Por ato mbështesin edhe shoqatat jo fitimprurëse dhe institucionet, duke qenë se ato lehtësojnë orientimin në këtë fushë nëpërmjet një pasqyre mbi ofertat për mësimin e gjuhës gjermane.

Të dish gjermanisht, ofron shumë avantazhe. Ju mund të

- > kualifikoheni më shpejtë dhe më mirë nga ana profesionale ose të filloni një punë
- > Të shoqëroni dhe mbështesni siç duhet fëmijën tuaj në shkollë
- > Të zgjeroni kontaktet taja sociale
- > në përgjithësi të merrni pjesë më fort në jetën e qytetit dhe qarkut të Heilbronn dhe të shfrytëzoni shanset tuaja.

Kjo broshurë i jep edhe familjeve me fëmijë këshilla të dobishme, se si ta mbështesin mësimin e gjuhës të fëmijës së tyre.

Ne ju urojmë shumë suksese në mësimin e gjermanishtes!

Landkreis Heilbronn
Bildungskoordination für Neuzuwanderer
Migration und Integration

Stadt Heilbronn
Stabsstelle Partizipation und Integration





PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
PËRMBAJTJA	5
KURSE INTEGRIMI	6
Informacione të përgjithshme	7
Aksesi për te kursi i integritimit	10
Ofruesit e kurseve të integritimit	17
KURSE GJERMANISHTJE TË TJERA	20
Kurse gjuhe profesionale (Deuföv)	21
Kurse gjuhe të qytetit dhe të rrethi i Heilbronn (VwV-Deutsch)	24
Kurset e gjuhës së akademisë aim	25
Kurset e shkollave të gjuhës kundrejt pagesës	25
Kurse online - mësimi i gjermanishtes në internet	26
TË MËSOSH GJERMANISHT DUKE STUDIUAR VETË	28
KËSHILLA PËR FAMILJET ME FËMIJË QË FLASIN DISA GJUHË	32
QENDRAT E KËSHILLIMIT	36



KURSE INTEGRIMI



INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

KUSH MUND TË MARRË PJESË?

Mund të marrin pjesë në kursin e integritit të huaj/-ja dhe gjermanë me prejardhje nga emigracioni me një detyrim me shkrim për pjesëmarrje, i cili është lëshuar nga zyra e të huajve ose nga Jobcenter. Edhe qytetarët/-et e Bashkimit Evropian (BE) mund të kërkojnë të marrin pjesë nëse ka vende të lira (për këtë gjë ndihmon instituti i gjuhës). Nëse plotësohen kushte të caktuara kursi është falas. Informacionet mbi aksesin në kursin e integritit për grupe të ndryshme emigrantësh i gjeni më poshtë.

Qëllimi:

Në kursin e integritit duhet të arrihet niveli i gjuhës B1. Niveli i gjuhës paraqet një bazë të mirë, për tu orientuar në shumë situata të jetës së përditshme.

Shkallët e nivelit të gjuhës me kornizën e përbashkët evropiane të të referencës përputhen me njohuritë e mëposhtme:

A1 - Fillestar:

marrja vesh me fjali të thjeshta është e mundur nëse flitet shumë ngadalë.

A2 - Njohuri bazë:

shkëmbimi i thjeshtë informacionit, p.sh. mbi prejardhjen ose arsimin me fjalë të thjeshta është i mundur

B1 - Të avancuar Përdorimi i gjuhës:

Shkëmbimi mbi tema të besueshme si puna, shkolla, koha e lirë, rezultatet, shpresat dhe objektivat është i mundshëm.

B2 - Të pavarur Përdorimi i gjuhës:

Përmbytjet kryesore të teksteve komplekse kuptohen, biseda spontane dhe të rrjedhshme mbi shumë tema janë të mundura. Niveli B2 është normalisht kushti gjuhësor për pjesëmarrjen e suksesshme në një arsim profesional.

C1 - Njohur të thella gjuhësore:

Kuptohen tekste të ndërlikuara. Gjuha brenda dhe jashtë profesionit/studimeve mund të përdoret në mënyrë fleksibël për tema të ndërlikuara.

C2 - Njohuri gjuhe të afërta me gjuhën amtare

Marrja vesh pa asnjë problem është e mundur; aftësi shumë të sakta shprehje me nuanca fine kuptimi.

LLOJI DHE KOHËZGATJA

Përveç kurseve të përgjithshme të integrimit (Integrationskurse) ekzistojnë edhe kurse speciale integrimi për analfabetë, për prindër ose kurse integrimi për të rinjtë për 18 - 27 vjeçar. Çdo kurs integrimi përbëhet nga një kurs gjuhe dhe një kurs orientimi (Orientierungskurs). Kursi gjuhës zgjat ndërmjet 700 orë mësimi (= UE; 1 UE = 45 minuta) dhe 1000 orë mësimi (kurse intensive 430 UE). Në përfundim të kursit të gjuhës vjen kursi i orientimit me 100 orë mësimi. Përmbajtja e kursit të orientimit janë historia, kultura dhe ligji në Gjermani.

SHPENZIMET

Falas pas kërkesës është pjesëmarrja në kursin e integrimit për ato emigrantë, të cilët përfitojnë shërbime sociale (pagesë papunësie II (Arbeitslosengeld II), ndihmë sociale (Sozialhilfe), pagesë për banesën (Wohngeld), pagesë shtesë për fëmijët (Kinderzuschlag), trajnim me ligjin federal për arsimin dhe nxitjen (BAFöG) ose trajtim sipas ligjit për trajtimin e kërkuesve të azilit) ose ato të cilët janë përjashtuar nga pagesa e shpenzimeve të çerdheve, kopshteve (Kita-Gebühr) ose nga pagesa e taksës së televizionit publik (GEZ-Gebühr). Për përpilimin e kërkesës ndihmojnë sponsorët e kursit të gjuhës. Edhe shtesat për kompensimin e shpenzimeve

të udhëtimit paguhen pjesërisht. Emigrantët me të drejtë pjesëmarrje në kursin e integrimit paguajnë për çdo 100 orë mësimi 195 Euro (në rastin e kalimit me sukses të kursit, gjysma i kthehet). Pjesëmarrësit pa të drejtë pjesëmarrje paguajnë 390 Euro për 100 orë mësimi (nuk i kthehet gjë). Nëse ekziston e drejta për të marrë pjesë, varet nga kushtet individuale.

REGJISTRIMI

Regjistrimi në kurset e integrimit kryhet direkt pranë instituteve të gjuhës. Ato ju këshillojnë në mënyrë individuale dhe kryejnë teste gjuhësore klasifikuese. Për më tepër ato ndihmojnë për parashtrimin e kërkesës për tu lejuar në kursin e integrimit (nëse nuk ekziston një detyrim). Ju lutemi merrni me vete për regjistrimin tuaj në shkollën e gjuhës, nëse aplikohet, vërtetimin tuaj aktual të trajtimit me shërbime ose vërtetime të tjera në lidhje me shërbimet sociale si p.sh. pagesa për banesën, pagesa për fëmijët ose përjashtimi nga pagesa e tarifave (p.sh. taksa e televizionit publik ose tarifa për kopshtin e fëmijëve). Pyetjeve të përgjithshme mbi kurset e integrimit i përgjigjen edhe qendrat përgjegjëse të qytetit ose të këshillit të qarkut Heilbronn (shihni informacionet e tjera).

KËRKIMI PËR KURSET NË RAJON

1. Hapni faqen webgis.bamf.de/BAMF/control
2. Klikoni mbi „Schnellsuche“ (në anën e majtë)
3. Jepni një vend ose kodin postar (PLZ)
4. Vendosni një grep te „Integrationskurs“ dhe zgjidhni llojin e kursit (p.sh. „allgemeiner Integrationskurs“). Mund të përzgjidhen ose tregohen si kurse në proces ashtu edhe kurse të planifikuara.

INFORMACIONE TË TJERA

Në faqet e internetit të Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët (Bundesamt für Migration und Flüchtlinge, BAMF) gjenden në dispozicion informacione të tjera: www.bamf.de/DE/Willkommen/DeutschLernen/deutschlernen-node; direkt tek ofruesit e kurseve (shihni F. 17 f.), ose te këshilluesit përgjegjës të emigracionit (shihni F. 37).

SI VEPROHET MË TEJ?

Pasi kursi i integritimit të jetë përfunduar me sukses/jo me sukses (ekziston mundësia e përsëritjes), mund të frekuentohet eventalisht një kurs gjermanishte që ka lidhje me profesionin (i

ashtuquajtur Rregullorja e nxitjes së mësimin të gjuhës gjermane (berufsbezogener Deutschkurs , DeuFöV)) ose një masë kualifikuese që ka lidhje me profesionin, gjë që ndërmjetësohet nga agjencia e punës (Arbeitsagentur) ose nga Jobcenter. Informacione të tjera japin sponsorët e kurseve të gjuhës ose ndërmjetësuesit/këshilltarët/-ret profesional pranë Jobcenter ose agjencisë së punës.

INFORMACIONE TË TJERA

INFORMACIONE MBI MËSIMIN E GJUHËS GJERMANE NË QARKUN E HEILBRONN

Landratsamt Heilbronn
Dezernat 6: Migration und Integration
Lerchenstraße 40
74072 Heilbronn
E-Mail: deutschkurse@landratsamt-heilbronn.de

Oraret e pritjes: E Hënë deri e Premte nga ora 8.30 – 12, e Mërkurë nga ora 13.30 – 18, Kati i 1-rë, zyra E140 – E144

Adresa e internetit:

www.landkreis-heilbronn.de/deutsch-lernen

**INFORMATIONSTELLE FÜR
INTEGRATIONSKURSE DER STADT
HEILBRONN**

Marktplatz 7

2. OG, Zi. 213A - 214

74072 Heilbronn

Telefon: 07131 563868

Telefon: 07131 561201

E-Mail: integrationskurs@heilbronn.de

Oraret e pritjes: E Hënë ora 8.30 - 12
E Martë, e Mërkurë, e Premte Nga ora
8.30 - 12, e Enjte nga ora 14 - 18

Adresat e internetit:

[www.heilbronn.de/leben/
partizipation-integration/
integrationskurse](http://www.heilbronn.de/leben/partizipation-integration/integrationskurse)

welcome.heilbronn.de/de/integration



AKSESI PËR TE KURSI I INTEGRIMIT

QYTETARËT/-ET E E BASHKIMIT EVROPIAN (BE), TË HAPËSIRËS EKONOMIKE EVROPIANE (EWR) DHE ZVICRËS

> Qytetarët/-ret e BE-së mund ta parashtrojnë kërkesën për tu lejuar në kursin e integrimit në kuadrin e vendeve të lira të kursit në rastin kur kanë njohuri jo të mirë të gjuhës gjermane ose kur nuk janë integruar në tregun e punës. Por nuk ekziston një detyrim ligjor për të marrë pjesë në një kurs integrimi. Kjo do të thotë, ato nuk kanë të drejtë të marrin pjesë.

> Formularët e kërkesave mund ti gjeni në faqet e internetit të Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët (BAMF): [www.bamf.de/
DE/Willkommen/DeutschLernen/
Integrationskurse/integrationskurse-
node](http://www.bamf.de/DE/Willkommen/DeutschLernen/Integrationskurse/integrationskurse-node). Miratimi mund të kërkohet edhe nëpërmjet sponsorit të kursit të integrimit (shkollës së gjuhës).

> Për çdo 100 orë mësimi, qytetarët/-ret e Be-së paguajnë një kontribut prej 195 Euro. Përfituesit/-set e pagesës së papunësisë II (Arbeitslosengeld II) ose të ndihmës sociale (Sozialhilfe) nëse parashtrojnë kërkesën do të përjashtohen nga shpenzimet. Ju lutemi që kur të regjistroheni të shkolla e gjuhës të sillni me vete aprovimin e pjesëmarrjes, kartën e identitetit (në rastin e personave të martuar edhe

atë të bashkëshortit/-es), dhe vërtetimin e përfitimit të shërbimeve.

> Në rastin kur keni kaluar me sukses testin përfundimtar, ato persona të cilët kanë paguar kursin e integritit, mund të kërkojnë pranë qendrës rajonale të Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët (BAMF) kompensimin e gjysmës së shpenzimeve të kursit (nëse ndërmjet datës së aprovimit të pjesëmarrjes dhe testit përfundimtar kanë kaluar maksimumi dy vjet).

GJERMANËT ME HISTORIK EMIGRACIONI

> Aprovimi është i mundur duke parashtruar kërkesën pranë Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët (BAMF) në rastin e njohurive ende të pamjaftueshme të gjuhës gjermane dhe kur integrimi nuk është kryer (p.sh. në tregun e punës).

> Formularët e kërkesave mund ti gjeni në faqet e internetit të Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët:

www.bamf.de/DE/Willkommen/DeutschLernen/Integrationskurse/integrationskurse-node.

Shkollat e gjuhës ndihmojnë normalisht në parashtrimin e kërkesës.

> Për çdo 100 orë mësimi duhen paguar 195 Euro shtesë. Përfituesit e shërbimeve sociale (informacione më të detajuara gjeni te „Shpenzimet“ në faqen 8, Kapitulli Kurset e integritit) Edhe për këtë gjë ndihmojnë institutet e gjuhës. Për tu regjistruar në kursin e gjuhës ju lutemi sillni me vete aprovimin e pjesëmarrjes, kartën e identitetit (te personat e martuar edhe atë të bashkëshortit/-es) dhe vërtetime eventuale të shërbimeve të përfituara.

TË SHPËRNGULURIT E MËVONSHËM

> Të shpërngulurit e mëvonshëm posedojnë tre drejtën të ndjekin një kurs integrimi (Integrationskurs) falas. Kjo vlen edhe për pjesëtarë të familjes, të cilët janë shënuar në vërtetimin e regjistrimit.

> Aprovimi individual i pjesëmarrjes lëshohet nga zyra federale e administrimit në Friedland kur kryhet udhëtimi.

BUNDESVERWALTUNGSAMT

Außenstelle Friedland

Heimkehrerstraße 16

37133 Friedland

Telefon: 0228 993589192

E-Mail: spaetaussiedler@bva.bund.de

www.bva.bund.de

QYTETARË/-E NGA VENDE TË TRETA

Personat nga vendet jashtë BE/ZEE/
Zvicrës

Personat me një leje qëndrimi prej minimumi 1 vit

> E drejta për një kurs integrimi ekziston nëse leja e parë e qëndrimit është lëshuar pas datës 01.01.2005:

- > si punëmarrës
- > për qëllimin e bashkimit familjar
- > për arsye humanitare
- > si person i autorizuar për qëndrim afatgjatë Kusht është normalisht një leje qëndrimi prej të paktën 1 vit. Pyetjeve mbi statusin e qëndrimit i përgjigjet zyra përgjegjëse e të huajve (Ausländerbehörde).
- > Nëse dispononi tashmë një certifikatë B1 ose nëse nevoja për tu integruar shihet që është e ulët, nuk posedoni të drejtën për një kurs integrimi.
- > Zyra e të huajve (Ausländer-behörde) ju detyron që të merrni pjesë në një kurs integrimi me marrjen e titullit të qëndrimit, nëse nuk është i mundur komunikimi i thjeshtë ose i mjaftueshëm në gjuhën gjermane. Përfituesit e pagesës së papunësisë II mund të detyrohen të marrin pjesë në kursin e integritimit edhe nga Jobcenter. Pyetje mbi detyrimin për të marrë pjesë në kursin e integritimit ju lutemi drejtojeni zyrës së të huajve ose Jobcenter!

> Për çdo 100 orë mësimi duhen paguar normalisht 195 Euro shtesë. Përfituesit e pagesës së papunësisë II (Arbeitslosengeld II), pagesa e banesës (Wohngeld) ose pagesa shtesë për fëmijët (Kindergeldzuschlag) ose personat, të cilët janë përjashtuar nga pagesa e taksës së televizionit publik (GEZ-/Kindergartengebühr) ose tarifës së kopshtit të fëmijëve, ose që trajtohen me ndihmë sociale, pas një kërkesë përjashtohen nga mbulimi i shpenzimeve. Për tu regjistruar në kurs pranë shkollës së gjuhës ju lutemi sillni me vete aprovimin e pjesëmarrjes, kartën e identitetit, për personat e martuar edhe atë të bashkëshortit/-es, dhe vërtetimin mbi shërbimet e përfituara.

Personat me një leje qëndrimi prej më pak se 1 vit

Nëse për personat me leje qëndrimi më të vogël se një vit ekziston mundësia e aprovimit të pjesëmarrjes në një kurs integrimi, duhet të sqarohet në rastin individual konkret me zyrën e të huajve (Ausländerbehörde).

Emigrantët që punojnë

Në varësi të statusit të qëndrimit, për emigrantë që punojnë mund të ekzistojë e drejta për të marrë pjesë në kursin e integritimit ose personi mund të lejohet të marrë pjesë në kursin e integritimit ose në një kurs gjermanishteje që ka lidhje me profesionin. Një situatë individuale mund të sqarohet te zyra e të huajve si dhe gjatë një konsulte personale pranë një ofruesi të kurseve të integritimit (shkollë gjuhe).

AU PAIRS

Au Pairs mund të marrin pjesë në kurse të ndryshme për mësimin e gjuhës gjermane pranë instituteve private të gjuhës duke paguar vetë. Shkollat më të shumta të gjuhës ofrojnë ulje të çmimeve për Au Pairs.

STUDENTËT NDËRKOMBËTAR

Studentët nga BE/ZEE/Zvicra ose nga vendet e treta

Studentët e përkohshëm/ me kohë të plotë

Studentëve ju lutemi që nëse interesohen për kurse të gjuhës gjermane ti drejtohen zyrës ndërkombëtare (International Office) ose qendrës së gjuhëve të shkollës së tyre të lartë. Për më tepër ato mund të përdorin si vetë-pagues mundësitë e larmishme të kurseve të instituteve gjuhësor privat. Normalisht ato paguajnë një çmim të leverdisshëm.

Personat që kanë përfunduar shkollat e larta

> Për personat që kanë përfunduar shkollat e larta nga BE/ZEE/Zvicra vlejnjë të njëjtat përcaktime si për qytetarët/-et e BE-së (shihni F. 10).
> Personat nga vendet e treta që kanë përfunduar shkollën e lartë me një diplomë gjermane mund të vizitojnë duke kryer një pagesë të plotë një kurs integritimi ose kurs gjuhe në një shkollë gjuhe private.
> Duke filluar nga niveli i gjuhës A2 mund të bëhet fjalë edhe për kurset e gjuhës që kanë të bëjnë me profesionin (DeuFöV, shihni F. 21).
Informacione mbi këtë gjë jep:

BUNDESAGENTUR FÜR ARBEIT

Rosenbergstraße 50
74074 Heilbronn
Telefon: 0800 4555500
[www.arbeitsagentur.de/
vor-ort/heilbronn/startseite](http://www.arbeitsagentur.de/vor-ort/heilbronn/startseite)

> Personat që kanë përfunduar shkollën e lartë, të cilët punojnë në një ndërmarrje, mund të interesohen për ndihmë për mësimin e gjuhës gjermane edhe pranë departamentit të personelit.

EMIGRANTËT AZILANTË

Personat me proces azili

Kërkuesit e azilit me një leje qëndrimi në përputhje me § 55 pika 1 e ligjit për azil (§ 55 Abs. 1 AsylG) me leje qëndrimi/kërkuesit e azilit me vërtetim mbërritje

> Kërkuesit e azilit nga Eritrea dhe Siria, gjatë procesit të azilit, me kërkesë pranë Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët (BAMF), mund të aprovohen që të marrin pjesë më parë në kursin e integritit (pavarësisht nga data e hyrjes së tyre në Gjermani).

> Azilantët të cilët i qasen punës me një leje qëndrimi të cilët kanë ardhur në Gjermani para datës 01.08.2019, mund të lejohen pas një kohë lejimi prej tre muajsh që të marrin pjesë në kursin e integritit. Afërsia me punën i referohet kritereve të mëposhtme:

> Ekziston një regjistrim pranë zyrës së punës si person që kërkon punë, që kërkon një arsim profesional ose si i papunë

> Ekziston një marrëdhënie pune ose arsimit profesional ose një pjesëmarrje në një kualifikim fillestar (Einstiegsqualifizierung, EQ)

> Pjesëmarrje te masa arsimore të cilat sigurojnë përgatitjen profesionale (Bildungsmaßnahmen, BvB) ose në fazën përgatitore arsimore të arsimit të asistuar (assistierten Ausbildung, AsA) Afërsia me punë duhet dokumentuar me një vërtetim, i cili i bashkëngjitet kërkesës për leje për në kursin e integritit. Regjistrimi si kërkues pune mund të kryhet pranë agjencisë së punës gjatë orëve të pritjes pa pasur nevojë që të lajmërosh më parë. Konfirmimi përkatës lëshohet direkt në vend.

> Azilantët me akses për te kursi i integritit janë të përjashtuar nga marrja përsipër e shpenzimeve. Shërbimi përgjegjës social ose menaxheri/-ja e integritit ju ndihmon për parashtrimin e kërkesës dhe jep informacione të tjera.

Kriteri i afërsisë me punë bie poshtë në rastin e prindërve me fëmijë që nuk kanë detyrim për të shkuar në shkollë.



Personat me proces azili, të cilët mund të lejohen më parë në kursin e integrimit, ti drejtohen për informacione mbi mundësi alternative për kursin e gjuhës, shërbimit të integrimit ose menaxhimit të integrimit. Mundësi të tejtra kurseesh gjuhe të kombinuara me pjesë praktike ka nëpërmjet:

**BUNDESAGENTUR FÜR ARBEIT
Rosenbergstraße 50
74074 Heilbronn
Telefon: 0800 4555500
[www.arbeitsagentur.de/
vor-ort/heilbronn/startseite](http://www.arbeitsagentur.de/vor-ort/heilbronn/startseite)**

Kërkuesit e refuzuar të azilit me leje qëndrimi

Kërkuesit e refuzuar të azilit, të cilët nuk mund të dëbohen, leje qëndrimi në përputhje me § 25 pika 3. e ligjit të qëndrimit (§ 25 Abs. 3. AufenthG)

> Përfituesit e shërbimeve sociale (informacione më të detajuara gjeni në „Shpenzimet“ në F. 8, Kapitulli Kurset e integrimit (Integrationskurs)) janë të autorizuar, që nëse ka vende të lira të marrin pjesë falas në kursin e integrimit.

> Të punësuarit duhet të paguajnë 50 % të shpenzimeve.

Personat që tolerohen § 60a pika 2 F. 3 e ligjit të qëndrimit (§ 60a Abs. 2 S. 3 AufenthG)

Personat, të cilët përkohësisht nuk mund të dëbohen

> Ky grup posedon të drejtë e pjesëmarrjes falas në kursin e integrimit nëse ka vende në dispozicion.

> Mbështetje ofrojnë punonjësit social/menaxherët e integrimit përgjegjës, qendrat këshillimore të emigrimit ose ofruesit e kurseve të integrimit (shihni F. 17).

> Të toleruarit pa tolerim të vlerësim sipas § 60a pika 2 F. 3 e ligjit të qëndrimit (§ 60a Abs. 2 S. 3 AufenthG) janë të përjashtuar nga pjesëmarrja në kursin e integrimit.

Azilantët e njohur me leje qëndrimi/mbrojtje ndihmëse

Personat që kanë të drejtën e azilit ose refugjatët sipas konventës së Gjenevës mbi refugjatët; Personat e njohur me pasaportë refugjati ose me një leje një vjeçare qëndrimi

> Ekziston e drejta për një kurs integrimi (në lidhje me shërbimet sociale pas kërkesës falas).

> Personat, të cilët nuk mund të merren vesh në një mënyrë të thjeshtë ose të mjaftueshme në Gjermanisht, janë të detyruar të marrin pjesë në kurs. Zyra e të huajve (Ausländerbehörde) e përcakton detyrimin e pjesëmarrjes në momentin e lëshimit të titullit të qëndrimit.


- > Përfituesit e pagesës së papunësisë II (Arbeitslosengeld II) mund të detyrohen të marrin pjesë në kursin e integritimit edhe nga Jobcenter.
- > Informacione të tjera merrni pranë shërbimit përgjegjës social-/integruës ose pranë menaxherëve të integritimit, pranë Jobcenter ose direkt tek ofruesit e kurseve të integritimit (shihni F. 17).

Refugjatët e ri-sistemuar (Resettlement-Flüchtlinge)

- Personat me një leje qëndrimi sipas § 23 pika 4 e ligjit të qëndrimit (§ 23 Abs. 4 AufenthG)
- > Refugjatët e ri-sistemuar (Resettlement-Flüchtlinge) kanë të drejtën e një kursi integrimi (në rastin kur trajtohen me shërbime sociale falas).
 - > Deklarohet një detyrim për pjesëmarrje në kursin e integritimit për personat, të cilët nuk mund të merren vesh në mënyrë të thjeshtë/ të mjaftueshme në gjermanisht. Zyra e të huajve e përcakton detyrimin e pjesëmarrjes në momentin e lëshimit të titullit të qëndrimit.

Tërheqja e familjarëve për personat që posedojnë të drejtën e mbrojtjes

- Personat që kanë ardhur në Gjermani me qëllimin e bashkimit familjar, p.sh. bashkëshorti/-ja, fëmijët ose pjesëtarë të tjerë të familjes (§§ 29, 30, 32, 36 i ligjit të qëndrimit (§§ 29, 30, 32, 36 AufenthG))
- > Ekziston e drejta për të marrë pjesë në një kurs integrimi (në rastin e trajtimit me ndihmë sociale falas).
 - > Personat, të cilët nuk mund të merren vesh në një mënyrë të thjeshtë në Gjermanisht, janë të detyruar të marrin pjesë në kurs. Zyra e të huajve (Ausländerbehörde) e përcakton detyrimin e pjesëmarrjes në momentin e lëshimit të titullit të qëndrimit.
 - > Përfituesit e pagesës së papunësisë II (Arbeitslosengeld II) mund të detyrohen të marrin pjesë në kursin e integritimit edhe nga Jobcenter.



OFRUESIT E KURSEVE TË INTEGRIMIT

AAW ARBEITSKREIS FÜR AUS- UND WEITERBILDUNG E.V.

Allee 40

74072 Heilbronn

Telefon: 07131 797926

E-Mail: Heilbronn@aaw.de

www.aaw.de

Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm

integrimi, Kurs alfabetizmi

Regjistrimi: Me telefon:

ARKUS GMBH

Happelstraße 17

74074 Heilbronn

Telefon: 07131 991230

E-Mail: sprachkurse@

arkus-heilbronn.de

www.arkus-heilbronn.de

Lloji i kursit: Kurs alfabetizmi,

Kurs integrimi për prindërit

Regjistrimi: Me telefon, Nga e Hëna
deri të Premten nga ora 9 - 12

ATACON-BILDUNG GMBH

Gottlieb-Daimler-Straße 25

74076 Heilbronn

Telefon: 07131 133570

E-Mail: info@atacon-bildung.de

www.atacon-bildung.de

Lloji i kursit: Kursi i përgjithshëm i

integrimin, kurs alfabetizmi, mësim

i shkruar të dytë (edhe mbrëmjeve
dhe në fundjavë) Të gjithë kursantët

me përkujdesje për fëmijët

Regjistrimi: E Hënë deri të Premten
nga ora 8 - 17

BILDUNGSPARK

HEILBRONN-FRANKEN GMBH

Hans-Rießer-Straße 7

74076 Heilbronn

Telefon: 07131 770700

E-Mail: info@bildungspark.de

www.bildungspark.de

Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm

integrimi, Kurs alfabetizmi, kurs

integrimi për prindërit, mësim i
shkruar të dytë

Regjistrimi: Me telefon,

E Hënë deri të Premten nga ora 8 - 12

CBZ MÜNCHEN GMBH

Gartenstraße 47

74072 Heilbronn

Telefon: 089 5426120

E-Mail: gkohler@cbz-muenchen.de

www.cbz-muenchen.de

Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm

integrimi, kurs alfabetizmi, mësim i
shkruar të dytë

Regjistrimi: Paradite në Heilbronn

GO LANGUAGE

Austraße 111

74076 Heilbronn

Telefon: 07131 7249870

E-Mail: info@golanguage.de

www.golanguage.de

Lloji i kursit: Kurs integrimi, kurs

intensiv mbi integrimin

Regjistrimi: Me telefon,

E Hënë deri të Premten nga ora 8 - 18

INTERNATIONALER BUND E.V.

Knorrstraße 8
74074 Heilbronn
Telefon: 07131 78090
E-Mail: BZ-Heilbronn@
internationaler-bund.de
www.internationaler-bund.de
Lloji i kursit:
Kurs integrimi për të rinjtë
Regjistrimi: Me telefon

SIH SPRACHINSTITUT

Allee 40
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 8882719
E-Mail: info@sih-heilbronn.de
Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm
integrimi
Regjistrimi: Me telefon,
E Hënë deri të Premten nga ora 9-18

USS GMBH

Etzelstraße 34
74076 Heilbronn
E-Mail: info.hn@uss.de
www.uss.de
Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm
integrimi, kurs alfabetizmi
Regjistrimi: Me telefon,
të Martave nga ora 10-16

USS GMBH

Salzstraße 185
74076 Heilbronn
Telefon: 07131 89895911
Llojet e kurseve: Kurs i përgjithshëm
integrimi, kurs alfabetizmi;
Kurs i përsëritësve
Regjistrimi: gjatë
orëve kur është hapur:
E Hënë deri të Enjten nga ora 8.30-16

VDV E.V.

Salzstraße 31
74078 Heilbronn
Telefon: 07135 35342018
E-Mail: info@vdv-leonberg.de
www.vdv-leonberg.de
Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm
integrimi (edhe mbrëmjeve)

VHS HEILBRONN

Kirchbrunnenstraße 12
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 996520
E-Mail: daf@vhs-heilbronn.de
www.vhs-heilbronn.de
Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm
integrimi (edhe mbrëmjeve), kurs
alfabetizmi, mësim i shkrimit të dytë
Regjistrimi:
E Martë + e Mërkurë
nga ora 10-13.30 edhe të
Enjteve nga ora 15-18,
klasifikimet me takim

VHS NECKARSULM

Seestraße 15

74172 Neckarsulm

Telefon: 07132 35370

E-Mail: vhs@neckarsulm.de

www.vhs-neckarsulm.de

Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm
integrimi (edhe mbrëmjeve)

Këshillim dhe regjistrim:

E Mërkurë nga ora 14 - 17.30

Orari i punë së sekretariatit

Gjermanisht si gjuhë e huaj:

E Hënë + e Enjte

nga ora 10 - 12 dhe 15 - 18

TRICOS GBR

Karlstraße 51

74072 Heilbronn

Telefon: 07131 1245722

E-Mail: heilbronn@tricos-gbr.de

www.tricos-bildung.de/

tricos-in-heilbronn

Lloji i kursit: Kurs i përgjithshëm
integrimi (edhe mbrëmjeve dhe në
fundjavë)

Regjistrimi: Të Martën deri të Enjten
nga ora 14 - 18 personalisht



KURSE GJERMANISHTJE TË TJERA



KURSE GJUHE PROFESIONALE (DEUFÖV)

Këto kurse janë kurse gjuhe që lidhen me profesionin me një numër orësh mësimore prej 400 deri 500 (secila prej 45 minutash), të cilat përmbajnë gramatikë dhe fjalor që lidhet me profesionin. Ofrohen kurset A2, B1, B2 dhe C1. Në këtë mënyrë duhet të lehtësohet komunikimi me kolegët/-et, eprorët dhe klientët. Përveç kurseve bazë profesional (Basisberufskurse) ekzistojnë edhe kurse speciale, të cilat të mësojnë gjermanisht që lidhet me profesionin për profesione të caktuara (p.sh. për profesionet jo akademike dhe akademike mjekësore). Kurset profesionale të gjuhës normalisht mund të frekuentohen nëse janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për pjesëmarrjen në kursin e integritit.

Mund të marrin pjesë:

- > Qytetar/-re nga BE/ZEE/Zvicër
- > Shtetasit/-et gjerman/-e me prejardhje nga emigracioni/të shpërngulurit e mëvonshëm
- > Personat që tolerohen sipas § 60a pika 2 fjalës 3 e ligjit të qëndrimit (§ 60a Absatz 2 Satz 3 AufenthG)
- > Të toleruarit që tregojnë afërsi me tregun e punës pas gjashtë muajsh tolerim.
- > Azilantë/-e që tregojnë afërsi me tregun, të cilët kanë ardhur në Gjermani para datës 01.08.2019 (pas tre muajsh lejim).

- > Emigrantë në kuadrin e bashkimit familjar
- > Azilantët e njohur
- > Personat me një leje qëndrimi sipas § 25 pika 5 e ligjit të qëndrimit (§ 25 Abs. 5 AufenthG)
- > Qytetarë/-e nga vende të treta me leje qëndrimi
- > Personat me leje qëndrimi nga Siria dhe Eritrea pas regjistrimit si të papunë ose që kërkojnë punë
- > Personat me leje qëndrimi nga Iraku, Irani dhe Somalia mund të marrin pjesë vetëm në kursin profesional të gjuhës, nëse ato kanë ardhur para datës 01.08.2019 dhe janë regjistruar pranë agjencisë së punës si të papunë ose persona që kërkojnë punë.

Përfundimet:

- > Azilantët nga vende me prejardhje të sigurt (Vendet e BE, Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Gana, Kosovë, Maqedoni, Republika e ish Jugosllavisë, Mali i Zi, Senegali, Serbia; Versioni: Korrik 2019)
- > Personat e vetë-punësuar (pavarësisht titullit të qëndrimit)

Agjencia e punës (Agentur für Arbeit) dhe Jobcenter akordojnë për klientët e tyre një aprovim pjesëmarrje. Edhe personat që punojnë dhe ato që ndjekin një arsimim profesional, të cilët nuk janë regjistruar në Jobcenter ose në agjencinë e punës, mund të marrin pjesë në mësimin e gjuhës që lidhet me profesionin, nëse njohuritë e tyre të gjuhës nuk mjaftojnë ende për të menaxhuar të përditshmen e tyre profesionale. Të drejtën për të marrë pjesë e kanë edhe personat që po kalojnë aktualisht proceset e njohjes së profesionit.

Një kërkesë vetjake për personat që punojnë/personat që ndjekin arsimin profesional mund të bëhet edhe direkt pranë Zyrës Federale për Emigracionin dhe Refugjatët (BAMF): www.bamf.de: Infothek / Berufsbezogene Sprachförderung / Berufsbezogene Sprachförderung gem. §45a AufenthG / Vordrucke und Formulare / „Antrag auf Teilnahmeberechtigung für Beschäftigte“ und „Antrag auf Teilnahmeberechtigung für Auszubildende“.

Pjesëmarrja në një kurs gjuhe profesional është normalisht falas. Të punësuarit, të ardhurat e tatueshme vjetore të cilëve tejkalojnë 20.000 Euro (në rastin e deklarimit të përbashkët 40.000 Euro), duhet të paguajnë një vlerë praj rreth 2 Euro për çdo orë mësimi. Personat që ndjekin arsimin profesional janë gjithmonë të përjashtuar nga pagesa. Edhe kompensime për shpenzimet e udhëtimit paguhen nëse përmbushen disa kushte të caktuara. Informacione në lidhje me këtë gjë japin sponsorët e kursit të gjuhës.

KËRKIMI PËR KURSE GJUHE QË LIDHEN ME PROFESIONIN (RREGULLORJA E NXITJES SË MËSIMIT TË GJUHËS GJERMANE (DEUFÖV))

- 1.** Hapni faqen www.kursnet.arbeitsagentur.de
- 2.** Shkruani në atë fushë termin e kërkimit „deuföv“ dhe në fushën vendin e organizimit „Heilbronn“
- 3.** Shtypni fushën starto kërkimin (Suche starten)

OFRUESIT E KURSEVE TË GJUHËS QË LIDHEN ME PROFESIONIN

AAW ARBEITSKREIS FÜR AUS- UND WEITERBILDUNG E.V.

Allee 40
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 797926
E-Mail: Heilbronn@aaw.de
www.aaw.de

BERLITZ DEUTSCHLAND GMBH

Marktplatz 13
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 5944809
www.berlitz.de

BILDUNGSPARK HEILBRONN-FRANKEN

Hans-Rießer-Straße 7
74076 Heilbronn
Telefon: 07131 770700
E-Mail: info@bildungspark.de
www.bildungspark.de

GO LANGUAGE

Austraße 111
74076 Heilbronn
Telefon: 07131 7249870
E-Mail: info@golanguage.de
www.golanguage.de
Regjistrimi: Me telefon,
E Hënë deri të Premten nga ora 8-18

INTERNATIONALER BUND E.V.

Knorrstraße 8
74074 Heilbronn
Telefon: 07131 78090
E-Mail: BZ-Heilbronn@
internationaler-bund.de
www.internationaler-bund.de

USS GMBH

Etzelstraße 34
74076 Heilbronn
Telefon: 07131 15533-0
E-Mail: info.hn@uss.de
www.uss.de

VHS HEILBRONN

Kirchbrunnenstraße 12
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 996520
E-Mail: daf@vhs-heilbronn.de
www.vhs-heilbronn.de

VHS NECKARSULM

Seestraße 15
74172 Neckarsulm
Telefon: 07132 35370
E-Mail: vhs@neckarsulm.de
www.vhs-neckarsulm.de



KURSE GJUHE TË QYTETIT DHE TË RRETHI I HEILBRONN (VWV-DEUTSCH)

Nëpërmjet programit të landit për nxitjen e mësimin të gjuhës „VwV Deutsch“, landi i Baden-Württemberg i vendos në dispozicion qyteteve dhe qarqeve çdo vit para për kurse të gjuhës gjermane“ (bashkë-financim nga qyteti dhe qarku). Programi i drejtohet të gjithëve, të cilët nuk kanë akses te kurset e integritit. Me këtë program nxiten kurse normale gjuhe, kurse gjuhe intensiv, kurse alfabetizimi si dhe kurse gjuhe për prindërit dhe gratë që kujdesen për fëmijët.

Informacion mbi kurset aktuale gjeni në:

Për banorë/-e të qytetit të Heilbronn:

Stadt Heilbronn
Stabsstelle Partizipation
und Integration
Lohtorstraße 27
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 562728
E-Mail: integration@heilbronn.de
welcome.heilbronn.de

Për banorë/-e të qarkut të Heilbronn:

Landratsamt Heilbronn
Migration und Integration
Lerchenstraße 40
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 9948470
E-Mail: deutschkurse@landratsamt-heilbronn.de
www.landkreis-heilbronn.de

KURSET E GJUHËS SË AKADEMISË AIM

Kurse gjermanishteje për nxënës/-e, persona që frekuentojnë arsimin profesional dhe për të rinj, të cilët dëshirojnë të studiojnë në Gjermani, ofrohen falas nga Akademie für Innovative Bildung und Management Heilbronn-Franken gGmbH (aim) Kurse zhvillohen në varësi të grupit të synuar gjatë pushimeve të shkollës ose gjatë javës, ditën ose në mbrëmje për nivele të ndryshme (A1-C1) dhe të pavarura nga prejardhja e emigrantëve. Informacione të tjera mbi kurset dhe mbi regjistrimin merrni nga Nadine Skrotzki, telefon: 07131 39097393, E-Mail: skrotzki@aim-akademie.org.

KURSET E SHKOLLAVE TË GJUHËS KUNDREJT PAGESESË

Pavarësisht mundësive të pjesëmarrjes në kurset e integritimit, të gjithë të interesuarit mund të shfrytëzojnë duke i paguar vetë mundësitë e larmishme të shkollave private të gjuhës. Shpesh ofruesit e kurseve të integritimit (shihni F. 17) kanë në program kurse të tjera të gjermanishtes në kohë të ndryshme dhe me orë mësimore edhe në fundjavë. Institute të tjera gjuhësore mund të kërkohen nëpërmjet faqeve të verdha ose në internet.



KURSE ONLINE – MËSIMI I GJERMANISHTES NË INTERNET

Në internet ekzistojnë mundësi të mrekullueshme për të mësuar gjermanisht. Disa prej tyre janë madje falas. Shumica e tyre janë të përshtatshme për mësimin e gjermanishtes duke studiuar vetë. Edhe një seri aplikacionesh ju mbështesin, pjesërisht kundrejt tarifave, gjatë mësimin të gjermanishtes.

Deutsche Welle:
www.dw.com/deutschlernen

Në versionin Desktop gjeni një numër shumë të madh kursesh gjermanishteje dhe ushtrime falas: Kurse gjermanishteje (në 29 gjuhë) nga A1 deri C2, Online-Learning, video, audio dhe und Podcasts – edhe fletë punë për ti printuar. Për më tepër atje ka:

- > Ushtrime për të gjitha nivelet
 - > Teste klasifikues
 - > Lajme që fliten me ngadalë
 - > Trajner për fjalorin
 - > Trajner për mënyrën e të shprehurit
- Një mundësi e kufizuar për mësimin e gjermanishtes mund të gjendet në versionin për telefon celular learngerman.dw.com.

> Goethe-Institut: [www.goethe.de / Online Deutsch lernen](http://www.goethe.de/Online/Deutsch/lernen)
Përveç mundësive kundrejt pagesës ekzistojnë edhe ushtrime online falas si p.sh. ushtrime mbi mënyrën e të shprehurit, ushtrime të fjalorit që lidhet me profesionin (për profesione sociale ose teknike, zejtari, zyrë, shërbime ose kulturë) – me detyra, intervista dhe filma.

> Shoqata gjermane e shkollave të larta: www.vhs-lernportal.de
Mundësi mësimi digjitale dhe falas e shoqatës gjermane e shkollave të larta (DVV) për kurse online falas për gjermanisht si gjuhë e dytë (A1–B2). Ka ushtrime për lexim, dëgjim, shkrim dhe të folur. Këtu mbështeten ato që mësojnë nga tutorë online.


> Mundësi online të mësuarit e bibliotekës së qytetit Heilbronn: stadtbibliothek.heilbronn.de
Për klientë të regjistruar të bibliotekës së qytetit ekziston mundësia onlinë LinguaTV për mësimin e gjermanishtes. Për më tepër ekzistojnë vende pune me laptopë dhe kompjuter në bibliotekë.

Punonjësit/-et e bibliotekës së qytetit ju ndihmojnë me kënaqësi për tu regjistruar. Kontributi si anëtar për të rriturit mbi 19 vjeç është 8 Euro për 3 muaj, 20 për një vit. Deri 19 vjeç përdorimi është falas.

Stadtbibliothek Heilbronn
im Theaterforum K3
Berliner Platz 12
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 562663
stadtbibliothek.heilbronn.de



TË MËSOSH GJERMANISHT DUKE STUDIUAR VETË



Jo gjithmonë frekuentimi i menjëhershëm i një kursi gjuhe është i mundur. Nganjëherë ekzistojnë edhe kohë pritje ndërmjet dy kurseve. Mbi të gjitha për njerëzit me përvojë të mësuarit, mësimi i gjermanishtes duke e studiuar vetë është një plotësim i mirë – që ka si kusht motivimin dhe disiplinën.

LIBRAT PËR MËSIMIN E GJUHËS PËR STUDIM VETJAK

Për të mësuar gjermanisht duke studiuar vetë ekzistojnë materiale të larmishme mësimore, p.sh. nga shtëpitë botuese PONS, Hueber, Klett dhe Cornelsen. Librat mësimorë janë pjesërisht gjermanisht-anglisht ose edhe në gjuhë të tjera. Në mënyrë që të jetë i mundur një vetë-kontroll, duhet që për librat e mësimit të gjermanishtes për vetë-studim të jenë në dispozicion edhe zgjidhjet për detyrat. Librat e dhëna këtu përmenden si shembuj. Libraritë në vend ju këshillojnë më tej. Një pasqyrë të këtyre librave mund ta shihni edhe pranë një biblioteke në vendin ku banoni. Këtu gjeni disa shembuj:

- > Kurs gjuhe plus gjermanisht (Hueber)
- > Motive, A1–B1 (Hueber)
- > Gramatikë aktive, A1–B1 dhe B2/C1 (Cornelsen)
- > PONS Gramatik shkurt & gjermanisht konçiz (PONS)
- > Për përgatitjen për provimin TELC ekzistojnë botime p.sh. nga shtëpitë botuese TELC dhe Klett.

TAKIMI GJERMANISHT PRANË BIBLIOTEKA E QYTETIT HEILBRONN

Gjithmonë të Hënave nga ora 15.30–17 zhvillohet një takim i hapur dhe falas gjerman. Këtu mësojnë, flasin dhe luajnë çdo javë një numër i madh mentorësh që flasin gjermanisht me miq nga e gjithë bota, të cilët dëshirojnë të mësojnë gjermanisht. Pjesëmarrja është falas dhe e në çdo kohe e mundur.

Stadtbibliothek Heilbronn
im Theaterforum K3
Berliner Platz 12
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 562663
stadtbibliothek.heilbronn.de

REVISTA „DEUTSCH PERFEKT“

Në dyqanet e mëdha të revistave (p.sh. në stacionin e trenit) ekziston revista mujore „Deutsch perfekt“ (Spotlight Verlag), që mbështet gjatë mësimit të gjermanishtes.

Më shumë informacione:
www.deutsch-perfekt.com

USHTRIMI I KOMUNIKIMIT NË PROGRAMIN E KUJDESIT „SPRACHE VERBINDET“

Pavarësisht origjinës, fesë ose moshës, emigrantët mund të trajnojnë komunikimin e tyre me gojë me banorët që flasin gjermanisht. Programi „Sprache verbindet“ realizohet në qytetin e Heilbronn nga ARGE Puna me refugjatët Heilbronn (ARGE Flüchtlingsarbeit Heilbronn) dhe në qarkun e Heilbronn (Landkreis Heilbronn) nga Caritas Heilbronn Hohenlohe. Punonjësit ndërmjetësojnë kujdestarë të gjuhës, me të cilët në takime të rregullta të organizuara vetë flitet gjermanisht.

Informacione të tjera dhe regjistrimi:

Kerstin Denner-Woerner
ARGE Heilbronn
Telefon: 0176 18980939
E-Mail: denner-woerner@
caritas-heilbronn-hohenlohe.de

Ndërmjetësimi i kujdestarëve gjuhësor në Neckarsulm dhe Bad Friedrichshall:

Brunhilde Massa
Telefon: 07132 5858
E-Mail: massa.b@
caritas-heilbronn-hohenlohe.de,
www.caritas-heilbronn-hohenlohe.de/
de/was-wir-bieten/treffpunkte/
sprache-verbundet

MËSIMI I GJERMANISHTES ME STAF MËSIMOR VULLNETAR

Në shumë komuna të qarkut ekzistojnë qarqe azili dhe ndihmësish, anëtarët e të cilëve japin mësim me bazë vullnetare. Kontakti për te qarqet e azilit ndërmjetësohet nga bashkitë.

CERTIFIKIMI I NJOHURIVE TË GJUHËS TË FITUARA VETË

Te shkollat e mëdha mund të kryeni një test gjuhe kundrejt pagesës së një tarife për të certifikuar njohuritë e gjuhës që keni arritur duke mësuar vetë. Ky test kushton në varësi të nivelit të gjuhës rreth 100–200 Euro. Informacion japin institutet gjuhësore (shihni tabelën). Një vlerësim falas i nivelit sipas kornizës referuese të përbashkët evropiane për gjuhët (GER) ofrojnë testet online si p.sh. ai i shtëpisë botuese Spotlight (Spotlight-Verlag):

www.sprachtest.de/
testi klasifikues në gjermanisht

Refugjatët mund ta kryejnë testin online të klasifikimit (onSET) falas, i cili jep një vlerësim mbi njohuritë ekzistuese të gjuhës.

refugees.onset.de



KËSHILLA PËR FAMILJET ME FËMIJË QË FLASIN DISA GJUHË



Të flasësh shumë gjuhë ka shumë avantazhe: Ju keni akses te kultura të ndryshme dhe fëmijët tuaj ndjehen si në shtëpi në shumë kultura. Fëmijët mund të mësojnë pa asnjë problem paralelisht gjuhë të ndryshme: në të njëjtën kohë, njëra pas tjetrës ose me njëra-tjetrën.

Në mënyrë që të ketë sukses në shkollë, është e rëndësishme që ai ta njohë mirë gjermanishten. Gjermanisht fëmija juaj mëson në çerdhe, në kopsht dhe në shkollë. Ju si prind jeni ndihmësit më të mëdhenj të fëmijës tuaj gjatë mësimit të gjermanishtes. Me këshillat e mëposhtme ne ju tregojmë juve, se si ta mbështesni fëmijën tuaj gjatë mësimit të gjuhës.

PËRDORENI NË MËNYRË AKTIVE GJUHËN NË FAMILJE

Flisni në shtëpi shumë me fëmijën tuaj. Përdorni gjatë këtyre bisedave gjuhë të cilën e flisni më me kënaqësi – „Gjuhën e zemrës tuaj“. Normalisht kjo është gjuha juaj e origjinës. Lutjuni fëmijës tuaj për shembull që t’ju ndihmojë: „Tani do të heqim rrobat nga këtu. Ti mund të palosësh çorapet. Pastaj unë do të vendos peshqirët në dollap.“ Në rastin e gjuhëve të ndryshme të origjinës së prindërve duhet që babai dhe nëna ta flasin gjuhën e tyre me fëmijën, p.sh. nëna rumanisht, babai gjermanisht. Këndoni me fëmijën tuaj edhe këngë për fëmijë nga atdheu juaj ose në gjuhë të tjera.

LEXO DHE LEXO ME ZË

Lexojini fëmijëve tuaj rregullisht me zë – më mirë çdo ditë, p.sh. para se ta zërë gjumi.

Këshillë:

Në projektin Lexo Amira www.amira-lesen.de ekzistojnë libra për fëmijë falas në shumë gjuhë në gjermanisht, italisht, turqisht, rusisht, arabisht, anglisht, polonisht, farsi dhe spanjisht. Historitë orientohen në fjalorin e shkollës fillore. Tekstet lexohen me ngadalë me zë. Nëpërmjet projektit Mulingula në www.mulingula-praxis.de mund të merrni – gjithashtu falas – libra për fëmijë në shumë gjuhë në gjermanisht, arabisht, farsi, polonisht, rumanisht, rusisht, tamilisht dhe turqisht.



FREKUENTIMI I ÇERDHE, PËRKUJDESJES DITORE PËR FËMIJË (KUJDESTARET/ KUJDESTARËT DITOR) OSE I KOPSHTIT

Sa më gjatë një fëmijë frekuenton çerdhen, kopshtin ose kujdesin ditor për fëmijë, aq më shumë kohë ka për të mësuar gjermanisht – dhe aq më mirë është i përgatitur për shkollë. Në çerdhe dhe në kopsht fëmijët mësojnë të dëgjojnë dhe të flasin dhe përvetësojnë një fjalor të madh: Me fillimin e shkollës, një fëmijë që ka gjermanishte si gjuhë të parë zotëron rreth mbi 5.000 fjalë të ndryshme. Nxënësit me një fjalor të madh mund ti kuptojnë më mirë përmbajtjet në mësim se sa nxënësit me një fjalor më të vogël. Në rastin më të mirë, fëmija juaj frekuenton një institucion ditor për fëmijë që para se të mbushë tre vjeç. Informacione mbi ofertat për kujdesin kundrejt fëmijëve gjeni në bashki.


ZGJERIMI I AKSESIT PËR TE GJUHA GJERMANE

Biblioteka:

Vizitoni me fëmijën tuaj bibliotekën e vendit ku jetoni. Për fëmijët dhe të rinjtë ekziston një dokument falas dhe ju me fëmijën tuaj mund të merrni borxh libra, libra për ti dëgjuar, lojëra dhe DVDs falas. Pyesni punonjës/-en e bibliotekës për libra, të cilat përshtaten me moshën e fëmijë tuaj. Bibliotekat për fëmijë bëjnë edhe oferta të mira për nxitjen e të lexuarit. Fëmijët të cilët janë mësuar me libra dhe lexojnë rregullisht, janë më mirë në drejtshkrim dhe në shkrimin e teksteve.

Mundësi për kalimin e kohës së lirë:

Kontrolloni (p.sh. në bashki), se çfarë mundësish për kalimin e kohës së lirë dhe për ushtrimin e sporteve ekzistojnë në afërsinë tuaj. Kur luan futboll, bën muzikë ose gjatë ndjekjes së hobeve të tjera fëmija juaj është në kontakt me moshatarët e vet. Në këtë



mënyrë përmirësohet aftësia për të komunikuar dhe ai gjen shokë.

Mundësitë në shkollë:

Pyesni në shkollën e tij për mundësi plotësuese kundrejt mësimit, p.sh. ndihmë për përgatitjen e detyrave të shtëpisë ose për orë të leximit me zë. Nëse ekziston një përkujdesje për orët e pasdites, shfrytëzojeni atë nëse është e mundur. Në këtë mënyrë fëmija juaj mëson më shpejt gjermanisht.

Kanali për fëmijë:

Nëse fëmija juaj ka filluar tashmë të mësojë gjermanisht, mund të shohë si masë plotësuese filma për fëmijë ose programe televizive të përshtatshëm për moshën e tij në kanalin për fëmijë (KIKA) (www.kika.de). Në këtë mënyrë përmirësohet aftësia për të kuptuar gjatë dëgjimit dhe zgjerohet

fjalori. Por filmat dhe programet për fëmijë duhet të përdoren me kohë të kufizuar. Ato i plotësojnë në mënyrë kuptimplotë masat e tjera por nuk i zëvendësojnë ato.

MËSONI VETË GJERMANISHT

Një sinjal i rëndësishëm për fëmijët është që prindërit të japin shembullin vetjak duke mësuar vetë gjermanisht. Ato shohin që mësimi i gjermanishtes është i rëndësishëm dhe që ja vlen. Kontrolloni mundësitë tuaja vetjake të merrni pjesë në një kurs gjermanishteje.



QENDRAT E KËSHILLIMIT



Informacione mbi temën e mësimit të gjuhës ose kursit të integritimit gjeni falas edhe në qendrat e mëposhtme.

KËSHILLIM PËR EMIGRIMIN

Qendrat e këshillimit janë të ndara në përgjegjësitë e tyre rajonale. Ekzistojnë qendra këshillimi për të rritur (Këshillim për emigrimin, MBE) dhe për të rinj (12–27, shërbimi i emigrimit të rinjve, JMD).

12–27 vjeç:

EVANGELISCHER JUGENDMIGRATIONSDIENST (JMD)

Schellengasse 7–9
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 9644801
E-Mail: jmd@diakonie-heilbronn.de

IN VIA JUGENDMIGRATIONSDIENST (JMD)

Bahnhofstraße 13
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 89809220
E-Mail: jmd.heilbronn@invia-drs.de

Duke filluar nga 27 vjeç:

MIGRATIONSBERATUNGSSTELLE (MBE) DIAKONISCHES WERK

Schellengasse 7–9
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 9644801
E-Mail: mbe@diakonie-heilbronn.de

MIGRATIONSBERATUNGSSTELLE (MBE) CARITAS-ZENTRUM HEILBRONN

Bahnhofstraße 13
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 89809300
E-Mail: migrationsberatung@caritas-heilbronn-hohenlohe.de

MIGRATIONSBERATUNGSSTELLE (MBE)

Kryqi i Kuq Gjerman
Shoqata e qarkut Heilbronn e.V.
Frankfurter Straße 12
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 623627
E-Mail: mbe@drk-heilbronn.de

WELCOME CENTER HEILBRONN-FRANKEN

Weipertstraße 8–10
74076 Heilbronn
Caktimi i takimit:
Telefon: 07131 7669868
Orari i hapur i pritjes: E Hënë nga ora
9–14, e Enjte nga ora 14–19
E-Mail: welcomecenter@heilbronn-franken.com
www.welcomecenter-hnf.com

**INFORMACIONE MBI MËSIMIN E
GJUHËS GJERMANE NË QARKUN E
HEILBRONN**

Landratsamt Heilbronn
Dezernat 6: Migration und Integration
Lerchenstraße 40
74072 Heilbronn
E-Mail: deutschkurse@
landratsamt-heilbronn.de

[www.landkreis-heilbronn.de/
deutsch-lernen](http://www.landkreis-heilbronn.de/deutsch-lernen)

**INFORMATIONSTELLE FÜR
INTEGRATIONSKURSE DER STADT
HEILBRONN**

Marktplatz 7
2. OG, Zi. 213A - 214
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 563868
Telefon: 07131 561201
E-Mail: integrationskurs@
heilbronn.de

[www.heilbronn.de/leben/
partizipation-integration/
integrationskurse](http://www.heilbronn.de/leben/partizipation-integration/integrationskurse)

welcome.heilbronn.de/de/integration



IMPRESSUM

Landratsamt Heilbronn
Lerchenstraße 40
74072 Heilbronn
Redaktimi: Heide Hindahl
Broshura është version i muajit Nëntor 2019.

Landkreis Heilbronn:

Migration und Integration
deutschkurse@landratsamt-heilbronn.de
Telefon: 07131 9948470

WWW.LANDKREIS-HEILBRONN.DE

Stadt Heilbronn:

Stabsstelle Partizipation und Integration
Lohtorstraße 27
74072 Heilbronn
integration@heilbronn.de
Telefon: 07131 562728

WWW.HEILBRONN.DE

Koncepti & Organizimi: DIE NECKARPRINZEN
Kommunikation und Design GmbH, Heilbronn



H | N Heilbronn

GEFÖRDERT VOM

